

GJYKATA KOMUNALE NE FERIZAJ, si gjykatë e shkallës së parë civile, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe procesmbajtësen Minire Krasniqi, në çështjen juridike-civile, sipas padisë së paditëses [REDAKTUAR] të cilën e përfaqëson, me autorizim [REDAKTUAR] nga Ferizaj kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga Ferizaj për shkak të mospërbushjes së kontratës, pas seances së shqyrtimit kryesor-publik, të mbajtur me datë 17.10.2012, në të cilën ishte e pranishme përfaqësuesi i autorizuar i paditëses e në mungesë të të paditurit, me datë 17.10.2012, muarr këto:

A K T G J Y K I M
PER SHKAK TË MUNGESËS

APROVOHET kërkesë-padija e paditëses [REDAKTUAR] në Prishtinë dhe **OBLIGOHET** i padituri [REDAKTUAR] nga Ferizaj që t'ia paguaj paditëses shumë prej 218.59 € në emër të përbushjes së kontratës si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 30€ dhe atë 15 € në emër të taksës gjyqësore për padi dhe 15 € për aktgjykim, të gjitha këto në afatin prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë

A r s y e t i m i

Paditësja [REDAKTUAR] - Prishtinë të cilin përfaqëson me autorizim [REDAKTUAR], me datë 22.09.2005, ka ushtruar padi kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga Ferizaj, për pagesën e borxhit në emër të mospërbushjes së kontratës për shfrytëzimin e shërbimeve telefonike mobile-roaming vala 900.

E autorizuar e paditëses në seancën e shqyrtimit kryesor mbajtur me datë 017.10.2012, ka deklaruar se ngel pranë padisë dhe kërkesë padisë dhe shtoj, se i padituri ka shfrytëzuar shërbimet e telefonisë mobile në bazë të kontratës për Valën 900 për Roving Europa për numrin e telefonit [REDAKTUAR] me nr. [REDAKTUAR] dhe përkundër nënshkrimit të kontratës, pranimit të kushteve të përgjithëshme të parapagimit me vallën 900 dhe vërejtjeve të dërguara për pagesë paraprakisht të paditurit nga paditësja, i padituri nuk i ka përbushur obligimet e veta kontraktuale. Prandaj i propozon gjykatës që kërkesë-padinë paditëses ta aprovoj si të bazuar, për shkak se ekzistojnë prova të pakontestueshme, se i padituri ka shfrytëzuar shërbimet e paditëses në shumë prej 218.59 €.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës në shumë prej 15 € për taksën gjyqësore për padi dhe 15 € për aktgjykim.

Në seancën e parë, të shqyrtimit kryesor, të mbajtur me datë 17.10.2012, nga fletkthesa e datës 02.10.2012, është konstatuar se i padituri ishte ftuar me rregull sepse zyrtari i kësaj gjykate, për dorëzimin e shkresave, ka vepruar drejtë kur ftesën së bashku me padinë dhe provat i ka lënë, nw dorezim, gruasë së të paditurit – te quajtur [REDAKTUAR] e cila pa ndonjë arsye ka refuzuar të nënshkruaj fletdërgesën e kësaj gjykate, për dorëzimin e shkresave, kështu që dorëzimi i tillë konsiderohet i vlefshëm në bazë të nenit 111 paragrafi 1 të LPK-se, e nisur nga fakti se i padituri nuk ka kontestuar kërkesëpadinë me anë të parashtresës dhe meqenëse nga faktet e treguara në padinë e paditësit si dhe nga provat dhe shkresat që gjinden në lëndë, rezulton si e themelt kërkesëpadija e paditëses, se gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë kundërshti në mes provave të propozuara dhe fakteve të parashtruara nga paditësja apo ato notore, se nuk kane ekzistuar shkaqe tjera notore, për gjykatën, që do të pengonin të paditurin, për pjesëmarrje në seancën e datës 17.10.2012 dhe pasi gjykata u sigurua se nuk ekzistojnë rrethana nga neni 3 paragrafi 3 të LPK-së, perkatesisht se nuk behet fjale, për objekt të cështjes kontestuese me të cilin palet nuk mund të disponojnë lirisht, e nga të gjitha keto, gjykata vlerësoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore sipas nenit 151 paragrafi 1 të LPK-se, ashtu që ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata duke u bazuar në nenin 2, 4.2, 7, 29, 142, nenin 151 paragrafi 1, nenin 160.2 dhe nenin 452.1 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA KOMUNALE NE FERIZAJ

C.nr.583/05 datë 17.10.2012

REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC.

Gjyqtari,
Enes Mehmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Republika e Kosovës



Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRĐUJE

Punëtori
Ovtašević

